



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA
MAQEDONASE PËR
EDUKIM
QYTETAR



PROJEKT I USAID-it PËR INTEGRIMIN NDËRETNIK NË ARSIM (PINA)

ÇKA ARRITËM DERI TANI?

PINA është iniciativë katërvjeçare me buxhet prej 5.2 milionë dollarësh, në të cilin janë përfshirë të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Maqedoni. Qëllimi kryesor i PINA-s është që ta fuqizojë vetëdijen dhe të sigurojë trajnime të ndryshme, mbështetje teknike dhe nxitje të këshillave të shkollave, drejtorëve, arsimtarëve dhe të administratës për ta mbështetur integrimin ndëretnik në arsim.

Aktivitetet e realizuara në këtë projekt gjatë periudhës janar - qershor 2014 janë paraqitur për secilin prej katër komponentëve që janë të ndërlidhur dhe që plotësohen mes vete.

INFORMIMI I OPINIONIT DHE BASHKËSIVE

- **Takime përgatitore për zgjedhjen e shkollave për zbatim të punëtorive kreative në gjashtë komunitat e reja të Fazës 3** u mbajtën në Kavadar, Koçan, Prilep, Gostivar, Ohër dhe Shkup në bashkëpunim me organizatën partnere Qendra për arte të aplikueshme "Multimedia" në të cilat u prezantuan aktivitetet e projektit dhe u dakorduan shkollat të cilat do të kyçen në trajnim dhe punëtoritë kreative për promovimin e diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkulturor.
- **Trajnim për trajnues për punëtori kreative** u realizua me arsimtarët e gjashtë shkollave të zgjedhura të Fazës 3 me qëllim që të ndërtohen kapacitetet e tyre për përgatitjen e moduleve dhe udhëheqjen e 12 punëtorive kreative të ardhshme me nxënësit.
- **Punëtoritë kreative** janë zbatuar në kuadër të gjashtë shkollave të zgjedhura në komunitat e reja të Fazës 3, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve, zgjerimit të njohurive dhe aftësive të mësimit për zhvillimin dhe zbatimin e integrimit ndëretnik përmes metodave dhe qasjeve kreative.
- **Debati forum teatral** u mbajt me ekipin e PINA-s, organizatat partnere, përfaqësuesit e USAID-it dhe trajnuesit master të involvuar në projekt.

- **Tri debate forume teatrale** u mbajtën me mësuesit-anëtarë të ekipeve për integrim shkollor nga shkollat fillore dhe të mesme nga më shumë komuna që u shfrytëzua si vegël për diskutim në kontekst të integrimit ndëretnik në arsim.
- **Janë mbajtur gjashtë trajnime për përpunimin e internet përmbajtjeve multimediale në kontekst të integrimit ndëretnik në arsim (Të rinjtë përmes mediave)** në bashkëpunim me IMM në të cilat morën pjesë nga dy nxënës dhe mësues të shkollave të mesme të rajoneve të Kavadarit, Prilepit, Koçanit, Gostivarit, Ohrit dhe një pjesë të shkollave të mesme nga Shkupi. Këto trajnime u ndihmojnë mësuesit dhe nxënësve të zhvillojnë aftësi për përgatitjen e internet përmbajtjeve multimediale përmes së cilave do t'i promovojnë aktivitetet e shkollave të tyre.
- **Debate publike** në kuadër të aktivitetit "Debate për integrimin në shkolla" janë mbajtur në klubet debatuuese të shkollave të mesme të komunave Kumanovë, Kërçovë, Shtip, Çair dhe Strugë të cilat nxënësit debatojnë i kanë shprehur qëndrimet e tyre përmes debatit në tema në lidhje me integrimin ndëretnik në arsim.
- **Është përgatitur një video e shkurtër me pjesëmarrësit në punëtoritë kreative** të



Është mbajtur në Shkup, trajnim për trajnues për punëtori kreative me arsimtarë të gjashtë shkollave të zgjedhura të Fazës 3.



Punëtori Forum teatral me arsimtarë-anëtarë të SIT të shkollave fillore dhe të mesme nga më shumë komuna nga Maqedonia, është mbajtur në Shkup.



shkollës së mesme “Arseni Jovkov”, me rastin e 8 Marsit, ditën e gruas në të cilën flitet për përfitimet e punëtorive kreative. Videoja është publikuar në linkun në vijim: <https://www.youtube.com/watch?v=WuyZ7KiHGxA>

- **Prezentohen produktet përfundimtare të hulumtimit të studimit të rastit nga ana e nxënësve të shkollës së mesme „Dimitria Çupovski“ në Veles.** Ekipi prej dhjetë hulumtuesve të rinj të çdo bashkësie etnike e përfaqësuar në shkollë i prezantoi praktikat e mira të dala nga hulumtimi.
- **Aktivitete të përbashkëta të nxënësve dhe ngjarje promovuese përfundimtare** për produktet e aktiviteteve midis shkollave partnere janë ndjekur dhe dokumentuar nga ana e ekipit të PINA-s. Storjet e aktiviteteve dhe prezantimeve janë publikuar në ueb faqen e PINA-s.
- **Ngjarje solemne me prerjen e shiritit** janë organizuar në tri shkolla në komunat Vinicë, Manastir dhe Koçan për shënimin e përfundimit të suksesshëm të procesit të renovimit.



Debat publik midis nxënësve të SHM “Cvetan Dimov” nga Qyteti i Shkupit dhe SHM “Josip Broz Tito” nga komuna e Qendrës. Debatit është pjesë e ciklit të quajtur “Debate për integrimin në shkolla”. Ngjarja u mbajt në ndërtesën komunesë së Çairit.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË DREJTORIVE TË SHKOLLAVE DHE ARSIMTARËVE

- **Është mbajtur Forum për integrimin ndëretnik në arsim** të fakulteteve për arsimtarë në Maqedoni, me qëllim që të zhvillohet koncepti për inkuadrim të integritit ndëretnik në arsimin e fakulteteve për arsimtarë.
- **Shtatë takime rajonale** janë organizuar në Koçan, Kavadar, Prilep, Gostivar, Ohër dhe Shkup me përfaqësues komunal, të shkollave fillore dhe të mesme të cilat janë të kyçura në Fazën 3 të zbatimit të projektit me qëllim që pjesëmarrësit të njoftohen me konceptin për integrimin ndëretnik në arsim dhe të marrin drejtimet për fillimin e aktiviteteve projektuese.
- **Është bërë rishqyrtimi i modulit bazë për trajnime për INA** në të cilin janë shtuar aktivitete praktike dhe video prezantim me shembujt e praktikave të suksesshme për zhvillimin e integritit ndëretnik në arsim. Është shtuar edhe sesioni për ndjekjen e aktiviteteve të INA-s në nivel të shkollës dhe janë bërë ndryshime në planifikimin vjetor.
- **Punëtori njëditore me trajnuesit master për mbështetjen e mentorëve** u mbajt me qëllim që të zhvillohen aftësitë e trajnuesve për mentorë përmes praktikimit të teknikave dhe strategjive për dhënien e informacioneve kthyesë për aktivitetet e përbashkëta të nxënësve me përbërje të përzier etnike.
- **Përfundojnë trajnimet e ekipeve për integrim shkollor** të ciklit trajnime treditore me SIT prej 183 shkollave fillore dhe të mesme të përfshira në Fazën 3 me qëllim që pjesëmarrësit të njoftohen me konceptin për INA.
- **Në bashkëpunim me ekipin e inspektorëve shtetëror të arsimit janë përshtatur instrumentet në Doracakun për vlerësimin integral** me çka mundësohet involvimi i elementeve të integritit ndëretnik në instrumentet përkatëse të cilat përdoren në vlerësimin integral.



FOTOGRAFIA E MUJAJIT



U nënshkrua Memorandum për partneritet midis shkollave SHF “Forina”, Gostivar dhe SHF “Nikolla Karev” nga Koçani gjatë një ngjarje solemne të prerjes së shiritit.



- **Punëtori dyditore** është mbajtur në Strugë për trajnimin e mësimdhënësve- trajnuesve për aktivitete të përbashkëta sportive dhe argëtuese me nxënësit, në të cilën morën pjesë ekipe të mësimdhënësve të 10 shkollave fillore më shumëgjuhëshe.
- **Katër takime të mentorëve për shkollat e Fazës 2 janë mbajtur** me qëllim të mbështetjes së shkollave për realizimin e suksesshëm dhe ndjekjen e aktiviteteve për integrimin ndëretnik.
- **Takime të mentorëve për përfaqësues të shërbimeve profesionale, Këshillave shkollorë dhe këshilltarëve komunal për arsim në pilot Fazë dhe Fazën 2 janë mbajtur** me qëllim që të shqyrtohet organizimi funksional midis të involvuarve në PINA në nivel lokal: të merret informacion kthyes për statusin e realizimit të aktiviteteve të INA dhe të definohen aktivitetet kyçe për target grupet.
- **Janë realizuar aktivitete të ndryshme të përbashkëta sportive dhe argëtuese** në të cilat morën pjesë 405 nxënës dhe 44 arsimtarë të nëntë shkollave fillore.
- **Takimi i parë i mentorëve i zbatuar** me 182 shkolla të Fazës 3 me qëllim që të sigurohet mbështetje e SIT për zbatimin e trajnimeve për disemim në nivel shkollor.
- **Trajnime me përfaqësues të shërbimeve profesionale dhe këshillave shkollorë për shkollat e Fazës 3,** janë realizuar me 158 shkolla në tetë grupe të përfaqësuesve me qëllim që të njoftohen pjesëmarrësit me qasjet, metodat dhe aktivitetet për përfshirje dhe pjesëmarrje aktive të prindërve në integrimin ndëretnik në shkolla dhe për kontribut praktik të këshillave shkollorë në ndryshimet për INA.
- **Koncepti për INA i vendosur në programet e lëndëve në fakultetet pedagogjike,** ndryshime të përgjithshme u futën në tetë programe mësimore, prej të cilave në katër programe mësimore janë futur ndryshime në mënyrë më të thuktë me deskriptorë të shënuar.



Aktivitete sportive dhe argëtuese me nxënësit e SHF "Alija Avdoviq" nga f. Batincë, komuna e Studeniçanit.



Nxënës morën pjesë në një ngjarje promovuese të produkteve nga aktivitetet e përbashkëta të nxënësve midis SHF "Braka Ramiz Hamid" nga komuna Shuto Orizare dhe SHF "7 Marsi" nga komuna e Çairit.

SHKOLLA MODELE

- **Takime konsultative me SIT dhe realizuesit e aktiviteteve** janë mbajtur në çdo shkollë modele për identifikimin e praktikave të mira gjatë realizimit të aktiviteteve projektuese. Është prezantuar edhe një model për krijimin e prezantimit për promovimin e projektit.
- **Takime konsultative** janë mbajtur me ekipet e përfshira në ndjekjen e aktiviteteve projektuese në shkollat modele me ç'rast janë analizuar arritjet me fokus në sfidat e radhës për çdo shkollë në veçanti.
- **Janë organizuar ngjarje promovuese** për aktivitetet projektuese të shkollave modele për gjithçka që është punuar në shkolla në gjysmëvjetorin e parë, me ç'rast çdo shkollë u prezentua me një pikë integruese.
- **Është mbajtur takim dyditor për këshillat shkollorë** të të gjitha shkollave modele në të cilin ishin të pranishëm këshilltarë të BZHA, përgjegjës për ndjekjen e aktiviteteve në shkollat modele dhe përfaqësues të organizatës partnere Sumnal me qëllim që të sensibilizohen anëtarët e KSH për aktivitetet e INA-s.
- **Takime të rregullta për mbështetje** janë realizuar në shkollat modele nga ana e ekipit të PINA-s me fokus në ndjekjen e aktiviteteve, përmirësim nga aspekti i arritjes së integritimit ndëretnik dhe planifikimin e ngjarjeve përfundimtare promovuese me produkte nga aktivitetet projektuese.





- **Trajnime për përfshirjen e prindërve në aktivitetet shkollore** të organizuara me prindërit prej gjashtë shkollave modele me qëllim që të njoftohen me konceptin e shkollës së integruar ideale nga aspekti i integritimit ndëretnik me ç'rast janë përpunuar edhe plane vepruese konkrete.
- **Pilotohen tetë punëtori për përvetësimin e gjuhës** në SHF "Petar Zdravkovski Penko" nga Shkupi, nga katër punëtori për dy grupe të formuara nga 20 nxënës të cilët mësojnë në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe.
- **Trajnim dyditor për prindër për ngritjen e vetëdijes për nevojën e mësimin të gjuhës së fqinjëve** i mbajtur nga të gjitha shkollat fillore modele me qëllim që të mundësohet njohja e strategjive të ndryshme për mësimin e gjuhës së "fqinjit" si dhe mësimin e barrierave të cilat e pamundësojnë këtë.
- **Dy trajnime me anëtarët e SIT të shkollave modele** janë mbajtur me SIT nga të gjitha shkollat fillore dhe të mesme me qëllim të ndërtimit të kohezionit grupor dhe bashkëpunimit midis anëtarëve të SIT nga çdo shkollë.
- **Dy trajnime për prodhimin e përmbajtjeve multimedial në internet në kontekst të integritimit ndëretnik në arsim** janë mbajtur me qëllim që t'u mundësojnë aftësi dhe njohuri bazë për krijimin e përmbajtjeve multimediale realizuesve të aktiviteteve të shkollave modele.
- **Organizohen katër manifestime në shkollat modele** me rastin e 7 Marsit, Ditës së mësuesit

shqiptar dhe 8 Marsit, Ditës së gruas në të cilat u realizuan pika integruese nga ana e nxënësve të gjuhëve të ndryshme mësimore.

- **Realizohen aktivitete me nismën e prindërve**, në SHF "Bratstvo Edinstvo" nga Ohri – festimi i festës 'Letnik', në SHF "Sande Shterjoski" nga Kërçova – përpunimi i stolive prej letre me rastin e ditës së pranverës, në SHME "Gostivari" – turne në futboll të vogël dhe aktivitete të tjera të shumta.
- **Punëtori me SIT të model shkollave partnere** janë mbajtur me qëllim që të zhvillohet strategji për realizimin e mëtejme të aktiviteteve projektuese, si dhe shqyrtimin e efekteve të aktiviteteve projektuese.
- **Tre ngjarje promovuese në shkollat modele** janë mbajtur në Kumanovë, Ohër dhe Gostivar në të cilat u promovuan aktivitetet dhe produktet përmes standave në panair përmes shfaqjes së përmbajtjeve multimediale nga të gjitha aktivitetet e ndërmarra në shkollat në kuadër të PIN-s dhe prezantimeve të ekipeve të integruara me disa pika të caktuara kulturore argëtuese. Në ngjarje morën pjesë një numër i madh i arsimtarëve, redaktorëve dhe prindërve si dhe përfaqësues të institucioneve arsimore lokale.
- **Është realizuar vetëvlerësimi i shkollave modele partnere** nga Kumanova me 60 nxënës, 30 prindër dhe arsimtarë si dhe anketues me ç'rast rezultatet janë përpunuar nga ekipi i PINA-s dhe u prezantuan në takim pune.



Pilotimi i punëtorive për përvetësimin e gjuhëve me nxënësit e klasave të para të SHF "Petar Zdravkovski Penko" nga Shkupi.

NXITJA E SHKOLLAVE

- **Thirrja për aplikim** është dorëzuar deri te 138 shkolla të mesme dhe fillore të 30 komunave të cilat kanë të drejtë të aplikojnë për zgjedhjen e 10 shkollave të reja të cilat do të përfshihen në aktivitetet e Komponentit 4 për vitin 2014.
- **Zgjidhen 10 shkolla të cilat do të përfshihen në aktivitetet e Fazës 3 të Komponentit 4 në vitin 2014.** U pranuan 99 aplikacione nga shkollat (70% jehonë).
- **Zgjidhen tri shkolla modele të cilat do të përfshihen në Komponentin 4 në vitin 2014.**

Selected schools in Component 4 – Phase 3

1	Pellagoni	Prilep	Topollçan	SHF	Krume Vollnaroski
2	Shkup	Kisella Vodë	Draçevë	SHF	Kuzman Shapkarev
3	Pollog	Gostivar	Çajle	SHF	Çajle
4	Pellagoni	Krivogashtan	Obërshan	SHF	Jonçe Smugreski
5	Shkup	Gjorçe Petrov	Shkup	SHF	Gjorçe Petrov
6	Shkup	Ilinden	Ilinden	SHF	Goce Dellçev
7	Pellagoni	Krushevë	Krushevë	SHF	Naum N. Borçe
8	Juglindje	Bogdanc	Bogdanc	SHF	Bogdanc
9	Pollog	Vrapçisht	Vrapçisht	SHF	Vrapçisht (Çede Filiposki)
10	Jugperndim	Dibër	Kosovrs i Poshtëm	SHF	Riste Ristevski
Shkolla modele					
1		Ohri		SHF	Bratstvo Edinstvo
2		Kërçova		SHF	Sande Shterjoski
3		Gostivar		SHME	Gostivar

- **Formohen ekipe për rinovimin e shkollave (ERSH)** në 10 shkolla të Fazës 3 dhe në tre shkolla modele.
- **Trajnime për ERSH për mirëmbajtjen e shkollave janë mbajtur** në të gjitha 13 shkollat e Fazës 3 me fokus në identifikimin e nevojave për rinovimin, definimin e prioriteteve dhe përgatitjen e aplikacionit për rinovim.
- **Trajnime për ERSH për mirëmbajtjen e shkollave janë mbajtur** në shkollat e njëjta me fokus në përgatitjen e planeve dhe buxheteve vjetore për mirëmbajtjen e shkollës dhe grumbullimin e mjeteve shtesë.
- **Bëhet pranimi teknik në SHF “Nikolla Karev” nga Komuna e Koçanit** për aktivitetet për ndërtimin e hyrjes kryesore në ndërtesën shkollare në SHF “Nikolla Karev” nga komuna e Koçanit të financuara nga MASH.
- **Është përgatitur plan i përbashkët për mbrojtjen e mjedisit jetësor** nga aktivitetet për rinovimin e shkollave të cilat mund të kenë ndikim negativ potencial. Plani është dorëzuar dhe miratuar nga USAID-i. Aktivitetet për rinovimin në shkolla të përfshira në punën e Komponentit 4 në vitin 2014 do të zhvillohen në pajtim me këtë plan për mbrojtjen e mjedisit jetësor.
- **Memorandume për bashkëpunim janë nënshkrua me kryetarët e komunave dhe**

drejtorëve të shkollave për rinovim në tetë shkolla të Fazës 3 me të cilat të gjitha palët e involvuara ndërmorën aktivitete në procesin e rinovimit.

- **Shpallen tenderë publik për zgjedhjen e zbatuesve** më të volitshëm të aktiviteteve për rinovimin e tetë shkollave, ndërsa për të gjitha tenderë u organizua hapje publike e ofertave.



Nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim për ndërmarrjen e obligimeve gjatë zbatimit të projektit për rinovimin e SHF “Gjorçe Petrov”, Shkup.

I presim rrëfimet, ngjarjet dhe risitë tuaja...

Na kontaktoni dhe këmbeni me ne në adresën: rr. Kozle 1-b, 1000 Shkup, info@mcgo.org.mk

BULETIN

Qershor 2014

DREJTPËRDREJT NGA PINA

6



Trajnim për vlerësimin e objekteve shkollore në të cilin morën pjesë përfaqësues të SHF "Sande Shterjoski" nga Kërçova, SHF "Bratstvo Edinstvo" nga Ohri dhe "Riste Ristevski" nga Kosovrasti i Poshtëm, Dibër.



Prerje solemne e shiritit me të cilin u shënuar fundi i procesit të rinovimit në shkollën fillore "Gorgi Sugarev" nga Manastiri.

A E DINI SE?

Faqja e USAID-it Maqedoni në Facebook, bashkë me Pakistanin, Nepalin dhe Jordaninë janë vende lidere me më shumë vizitorë.

Për momentin kemi mbi 16 000 „pëlqime“.

Vazhdoni ta vizitoni faqen e USAID-it Maqedoni në Facebook dhe



Projekti i USAID-it për integrimin ndëretnik ne arsim implementohet në partneritet me shtatë organizata lokale: Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhje të Konfliktëve, Loja, Sumnal, Multimedia, Moja kariera, Instituti Maqedonas i Mediave dhe Forumi Arsimor i të Rinjve.

INFORMACIONE DHE KËSHILLA TË DOBISHME

Ueb faqja jonë

www.pmio.mk

ofron informacione lidhur me Projektin e USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim - ngjarje, rrëfime dhe mundësi të ndryshme, të përgatitura dhe të mundësuar nga ekipi i projektit dhe bashkëpunëtorët tanë.

Ju ftojmë ta vizitoni!

Ne jemi edhe aty të pranishëm me rrëfimet tona të suksesshme!

DIÇKA E PADETYRUESHME NGA PINA



Me rastin e 8 Marsit Magdalena dhe Artiana, nxënëse të cilat ishin pjesë e punëtorive kreative në shkollën e mesme "Arseni Jovkov" nga Shkupi, flasin për miqësinë e cila është krijuar midis tyre gjatë punëtorisë.

Informacionet e dhëna në këtë buletin nuk janë informacione zyrtare të Qeverisë së SHBA-ve dhe nuk i paraqesin pikëpamjet ose qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së SHBA-ve.